



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Data: 30. 04. 2026

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

Objekti i Procedurës: “Blerje karburant”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Karburante- 09100000-0.Karburant diesel-09134100-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,926,682.50 lekë (dy milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

- **Loti 1: “Blerje Gazoili 10ppm”**, me fond limit: **2,780,019.50** (dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

- **Loti 2: “Blerje Benzinë pa plumb (Premium Unl 10ppm)”**, me fond limit: **146,663** (njëqind dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë: **Procedurë e Hapur e thjeshtuar, mallra.**

Arsyet e përdorimit të procedurës - “ E hapur e thjeshtuar”, Mallra, është sepse vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar.

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 2 pika “c”, nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale, ka hartuar

procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

LOTI 1 “BLERJE GAZOILI 10PPM”, ME FOND LIMIT: 2,780,019.50 (DY MILION E SHTATËQIND E TETËDHJETË MIJË E NËNTËMBËDHJETË PIKË PESËTËDHJETË) LEKË PA TVSH.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentim: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 76, 77, pika 1/a dhe 2; Nenin 25, 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2/c dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, për të gjitha vëndet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mesepërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43 pika 6, nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar, nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB", i ndryshuar.

Per të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Janë kërkuar këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen

e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 40 pika 4, neni 55 pika 4/b. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4

të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante ose liçencë për tregtim me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj të llojit VIII.1.A [Gazoil/ Diesel (10PPM) dhe Benzine pa plumb (premium unl 10ppm)].

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”; nenit 40, pika 5, gërma ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, vetëm për blerje karburanti, lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) dhe Benzinë të cilat kërkojnë leje të veçantë për tregtimin me pakicë të këtij malli. Bazuar dhe në Vendim nr.970 datë 2.12.2015 ” Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësisve të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga: **b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësisve të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.**

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë/raport analizë për gazoil 10ppm dhe benzine pa plumb, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 40, pika 6 gërma ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga ISHTI që subjekti ofertues nuk ka penalitete për shkelje të cilësisë së karburantit brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 40, pika 6 gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofron produktin me cilësi duke respektuar standartet Ligjore. Vërtetim i lëshuar nga ky institucion siguron Autoritetin Kontraktor që ofrohet furnizim me karburant cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë minimalisht 1(një) pikë karburanti sa më afër varrezave publike Sharrë dhe Tufinë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e rregjistrimit tregtar lëshuar nga QKB, etj).

Këto stacione duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin si më poshtë:

- a- Lejen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, lëshuar nga QKL;
- b- Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI/nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- c- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri/Akt teknik lëshuar nga MZSH;
- d- Policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të

paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; në nenin 40, pika 5 gërma a, pika 8 e VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion“. Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 date 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombetare. Akti teknik lëshuar nga PMNZH është i rëndësishëm, pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marre masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar. Nëpërmjet kësaj procedure do të merret artikulli gazoil (diesel) dhe benzinë pa plumb sipas funksionalitetit që ka në objektin e veprimtarisë së tij Autoritetit kontraktor, në zbatim të detyrave funksionale realizohet lëvizja e mjeteve të institucionit. Për këtë arsye, stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve janë kërkuar të jenë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës dhe sa më afër varrezave publike Sharrë dhe Tufinë, për të pasur mbulim sa më të mirë të furnizimit përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e furnizimit. Automjeti për t’u furnizuar me karburant, nuk ka pse të pershkoje distanca të largëta duke humbur kështu kohë dhe gjithashtu duke rritur në mënyrë artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit dhe përveç kesaj, meqenëse shumica dërmuese e mjeteve dhe automjeteve i përkasin dhe punojnë kryesisht në territorin e varrezave publike Sharrë dhe Tufinë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me pika shitje karburanti me shërbim 24 orë sipas standarteve në fuqi, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jenë pa skadencë deri në përfundimin e plotë të sasisë së karburanit.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet karteve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Keto deklaratat shërbejnë si garanci për Autoritetin

Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe operatori ekonomik kontraktues merr persiper permbushjen e ketyre kerkesave.

7. Certifikat ISO:

a) **ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) **ISO 14001 -2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

***Shënim:** Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njëhësuar me origjinalin (kopje të noterizuar). Certifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga një BO, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

Ne nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

- Çertifikata S SH EN ISO 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/ të barazvlefshme, është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që: Standarti ISO 14001 Sistemi i Menaxhimit Mjedisor është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë herbicide dhe pesticide, si dhe duke vlerësuar faktin që këto mallra do të përdoren për spërkatje në ambiente publike, paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që këto mallra do të prokurohen nga OE, që i plotësojnë kërkesat minimale të ndikimit në mjedis.

Për të gjitha sa më sipër, kjo certifikatë është kërkuar me qëllim garancinë e AK se ofertuesi ka potencialin e duhur për ushtrimin e veprimtarisë së tij, sa i takon të gjitha aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore, dhe rrjedhimisht garanton AK mbi vazhdimësinë e zbatimit të kontratës që do të lidhet.

8. Bazuar në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme” Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Për këtë kriter duhet të paraqesë **Propozimin /manualin për administrimin e webpage.**

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Është kërkuar që operatori ekonomik të vetëdeklarojë sa mësipërm pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas VKM Nr 561 datë 29.07.2016 "Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Si dhe është një kusht që verteton që operatori ekonomik është realisht e përdorur në mënyrë të shpërndarjes me karta si dhe ka funksional dhe webpajesën që të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2: “BLERJE BENZINË PA PLUMB (PREMIUM UNL 10PPM)”, ME FOND LIMIT: 146,663 (NJËQIND DYZET E GJASHTË MIJË E GJASHTËQIND E GJASHTËDHJETË E TRE) LEKË PA TVSH.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentim: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojme Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 76, 77, pika 1/a dhe 2; Nenin 25, 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit

limit te përllogaritur. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2/c dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit te përllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet*”:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për këstet e maturuara për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit 9632, datë 30.10.2006 ”Per Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, për të gjitha vëndet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit sipas shtojcës 9 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten

nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mesepërme është percaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 6, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, i ndryshuar.

Për të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Janë kërkuar kështu e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kështi për periudhën përkatëse të maturuar për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për kështu e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kështi për periudhën përkatëse të maturuar pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 40 pika 4, neni 55 pika 4/b. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit. Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante ose liçencë për tregtim me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj të llojit VIII.1.A [Gazoil/ Diesel (10PPM) dhe Benzine pa plumb (premium unl 10ppm)].

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një

veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë’; nenit 40, pika 5, gërma ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, vetëm për blerje karburanti, lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) dhe Benzinë të cilat kërkojnë leje të veçantë për tregtimin me pakicë të këtij malli. Bazuar dhe në Vendim nr.970 datë 2.12.2015 ” Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga: **b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.**

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë/raport analizë për gazoil 10ppm dhe benzine pa plumb, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 40, pika 6 gërma ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standardet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga ISHTI që subjekti ofertues nuk ka penalitete për shkelje të cilësisë së karburantit brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 40, pika 6 gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 8450, datë

24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofron produktin me cilësi duke respektuar standartet Ligjore. Vërtetimi i lëshuar nga ky institucion siguron Autoritetin Kontraktor që ofrohet furnizim me karburant cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë minimalisht 1(një) pikë karburanti sa më afër varrezave publike Sharrë dhe Tufinë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB, etj).

Këto stacione duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin si më poshtë:

- a- Lejen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, lëshuar nga QKL;
- b- Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI/nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- c- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri/Akt teknik lëshuar nga MZSH;
- d- Policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; në nenin 40, pika 5 gërma a, pika 8 e VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion“. Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 date 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombëtare. Akti teknik lëshuar nga PMNZH është i rëndësishëm, pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Nëpërmjet kësaj procedure do të merret artikulli gazoil (diesel) dhe benzinë pa plumb sipas funksionalitetit që ka në objektin e veprimtarisë së tij Autoritetit kontraktor, në zbatim të detyrave funksionale realizohet lëvizja e mjeteve të institucionit. Për këtë arsye, stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve janë kërkuar të jenë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës dhe sa më afër varrezave publike Sharrë dhe Tufinë, për të pasur mbulim sa më të mirë të furnizimit përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e furnizimit. Automjeti për t’u furnizuar me

karburant, nuk ka pse të pershkoje distanca të largëta duke humbur kështu kohë dhe gjithashtu duke rritur në mënyrë artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit dhe përveç kesaj, meqënëse shumica dërmuese e mjeteve dhe automjeteve i përkasin dhe punojnë kryesisht në territorin e varrezave publike Sharrë dhe Tufinë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me pika shitje karburanti me shërbim 24 orë sipas standarteve në fuqi, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jenë pa skadencë deri në përfundimin e plotë të sasisë së karburanit.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet karteve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Keto deklaratat shërbejnë si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe operatori ekonomik kontraktues merr përsiper permbushjen e ketyre kërkesave.

7. Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) **ISO 14001 -2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: *Çertifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njëhësuar me origjinalin (kopje të noterizuar). Çertifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorezohet nga një BO, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

Ne nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

- Certifikata S SH EN ISO 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/ të barazvlefshme, është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që: Standarti ISO 14001 Sistemi

i Menaxhimit Mjedisor është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë herbicide dhe pesticide, si dhe duke vlerësuar faktin që këto mallra do të përdoren për spërkatje në ambiente publike, paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që këto mallra do të prokurohen nga OE, që i plotësojnë kërkesat minimale të ndikimit në mjedis.

Për të gjitha sa më sipër, kjo certifikatë është kërkuar me qëllim garancinë e AK se ofertuesi ka potencialin e duhur për ushtrimin e veprimtarisë së tij, sa i takon të gjitha aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore, dhe rrjedhimisht garanton AK mbi vazhdimësinë e zbatimit të kontratës që do të lidhet.

8. Bazuar në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme” Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Për këtë kriter duhet të paraqesë **Propozimin /manualin për administrimin e webpage.**

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor.

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Është kërkuar që operatori ekonomik të vetëdeklarojë sa mësipërm pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas VKM Nr 561 datë 29.07.2016 "Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme". Si dhe është një kusht që vertetohet që operatori ekonomik është realisht e përdorur në mënyrë të shpërndarjes me karta si dhe ka funksional dhe webpagen që të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej

anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE:

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Europiane të lëndëve djegëse 98/70/EWC, Amendamentit 2003/17/EC, Amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diezel”.

LOTI 1: “BLERJE GAZOILI 10PPM”

1. Specifikimet teknike Karburant lloji GAZOIL (10 ppm)

Specifikimet teknike dhe kërkesat për produktin Naftë duhet të jenë sipas standartit Shqiptar SSH EN 590:2022, “Lëndë djegëse e lëngët për automjete - Gazoil (Diesel)”, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit në VKM-në nr. 147, date 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse Benzine dhe Diezel”.

➤ GAZOIL (10 ppm)

Gazoili analizohet sipas standartit SSH EN 590:2022

Nr	Treguesit	Njësia matjes	Kufijtë		Rezultati
			Minimum	Maksimum	
1	Numri i cetanit		51.0		
2	Indeksi i cetanit		46.0		
3	Densiteti ne 15 °C	Kg/m ³	820,0	845,0	
4	Hidrokarburet aromatik policiklike	% m/m	-	8,0	
5	Permbajtja e squfurit	mg/kg		10,0	
6	Pika e flakërimit	°C	55	-	

7	Mbetja e karbonit (ne 10 % mbetje distilimi)	% m/m	-	0,30	
8	Permbajtja e hirit	% m/m	-	0,010	
9	Pika e bllokimit te filtrit ne te ftohte CFPP	°C			
10	Korrozioni ne shufer bakri (3 ore ne 50 °C)	vleresim	Klasa 1		
11	Permbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7,0	
12	Viskoziteti ne 40°C	mm ² /s	2,00	4,50	
13	Distilimi :				
	Distilati qe vlon deri ne 250°C, % (v/v)	% v/v	-	< 65	
	Distilati qe vlon deri ne 350°C, % (v/v)	% v/v	85		
	95 % (v/v) distilon ne	°C		360	

LOTI 2: “BLERJE BENZINË PA PLUMB (PREMIUM UNL 10PPM)”

2. Specifikimet teknike për Karburant lloji Benzinë:

- Specifikimet teknike dhe kërkesat për produktin Benzinë duhet të jenë sipas standartit Shqiptar SSH EN 228:2012+A1:2017, "Lëndë djegëse për automjete - Benzinë pa plumb", të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit dhe të përcaktuara në VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse Benzinë dhe Diezel”.

➤ BENZINE PA PLUMB

Benzina analizohet sipas standartit SSH EN 228:2012 + A1:2017

Nr	Treguesit	Njesia matjes	Kufijte		Rezultati
			Minimum	Maksimum	

1	Numri i oktanit kerkimor NOK		95	-	
2	Numri i oktanit motorrik NOM		85	-	
3	Densiteti ne 15 °C	kg/m ³	720,0	775,0	
4	Permbajtja e sqfurit	mg/kg	-	10,0	
5	Korozioni i shufres se bakrit (3 ore / 50 °C)	Renditje	Klasa 1		
6	Tensioni i avujve	kPa	45	100	
7	Pamja e jashtme		E paster dhe e tejdukshme		
8	Destilimi				
a	Distilon deri 70 °C	% v/v	20	48	
b	Distilon deri 100 °C	% v/v	46,0	71,0	
c	Distilon deri 150 °C	% v/v	75	-	
d	Pika finale e distilimit	°C	-	210	
e	Mbetjet e distilimit	% v/v	-	2	
9	Permbajtja e tipit te hidrokarburit				
a	Olefinat	% v/v	-	18,0	
b	Aromatiket	% v/v	-	35,0	
10	Permbajtja e benzenit	% v/v	-	1,0	
11	Permbajtja e oksigjenit	%(m/m)	-	2,7	
12	Permbajtja e komponimeve oksigjenore				
a	Methanol (alkool metilik)	% v/v	-	3	
b	Etanol (alkool etilik)			5	
e	Alkool terc - butil			Perzierja ne vellim i kufizuar ne 2.7 % (m/m) te permbajtjes maksimale te oksigjenit	
f	Komponime oksigjenore te tjera				
g	Etere (me 5 ose me shume atome C)				

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllëgarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

1. Sasitë e kërkuara nga AK, janë sasi të pritshme, e llogaritur në bazë të çmimit mesatar për litër nëpërmjet studimit të tregut dhe llogaritjen sipas nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar . Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të çmimit të publikuar nga APP në buletin javor.

2.Do të jetë AK ajo që do të përcaktojë sasitë përkatëse gjatë zbatimit të kontratës. Operatorët do të ofertojnë me fitim në lek për litër. Ky fitim do të jetë i pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave. Fitimi si për GAZOIL (10 ppm) dhe për BENZINE PA PLUMB do të jetë i njëjtë. Sasia e kërkuar nga autoriteti është sasi e pritshme, për të cilën autoriteti do të shprehet në momentin e nënshkrimit të kontratës.

2.1. Formulari i ofertës të përfshijë element si më poshtë:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftime Publike;
- b) elementet fiskale;
- c) marzhi i fitimit të shprehur në vlerë absolute, i cili duhet të jetë i pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.
- d) për të dy llojet e karburantit (GAZOIL (10 ppm) dhe për BENZINE PA PLUMB marzhi i fitimit duhet të jetë i njëjtë.

Gjatë kohës së zbatimit të kontratës, për furnizimin me karburant, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë egzekutimit të kontratës në rast të luhatjes së cmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar nga APP pas dërgimit të këtij çmimi për publikim, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktori.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialisti fushës me shkresën me nr. 449/6 prot., datë 20. 04. 2026*

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel” dhe standardeve shtetërore në fuqi SSH EN 590:2022 +A1:2017 dhe standartit SSH EN 228:2012 + A1:2017. Për këtë objekt prokurimi autoriteti kontraktor ka përdorur specifikimet teknike duke ju referuar standardeve kombëtare, të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve.

Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) dhe Benzinë pa plumb duhet të ketë këto karakteristika: Diezel, (Gazoil) të jetë sipas standartit SSH EN 590:2022 +A1:2017 dhe Benzinë pa plumb të jetë sipas standartit SSH EN 228:2012 + A1:2017

Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Në zbatim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.

III. SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Fondi limit total për procedurën e prokurimit me objekt: “**Blerje karburant**”: **2,926,682.50 lekë** (dy milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

- **Loti 1: “Blerje Gazoili 10ppm”**, me fond limit: **2,780,019.50** (dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

- **Loti 2: “Blerje Benzinë pa plumb (Premium Unl 10ppm)”**, me fond limit: **146,663** (njëqind dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	PËRSHKRIMI I MALLIT	NJËSIA	SASIA
1	GAZOIL (10 ppm)	Liter	16515
2	BENZINE PA PLUMB	Liter	1000

GRAFIKU I LËVRIMIT TË OBJEKTI: “BLERJE KARBURANT” 2 LOTE

LOTI 1: "BLERJE GAZOIL 10PPM"

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Gazoil 10ppm	litër	16515	2360	2360	2360	2360	2360	2357	2358

VO: Sasia do të ndryshojë në varësi të ngarkesës së punës.

AFATI LEVRIMIT: Deri në ezaurimin e fondit limit.

- Sasitë e pa konsumuara të karburantit ruajnë vlefshmërinë e tyre dhe pas afatit të përcaktuar, ku operatori ekonomik duhet të vazhdojë furnizimin me karburant nëpërmjet kartës elektronike, deri në konsumimin e plotë të gjithë sasisë së karburantit të blerë (dhe pas mbarimit të vitit kalendarik 2026).

GRAFIKU I LËVRIMIT TË OBJEKTI: "BLERJE KARBURANT" 2 LOTE
LOTI 2: "BLERJE BENZINË PA PLUMB (PREMIUM Unl 10PPM)"

Nr .	Emertimi	Njesi a	Sasia	Qersho r	Korri k	Gusht	Shtato r	Teto r	Nento r	Dhjetor
1	Benzinë pa plumb (Premium Unl 10ppm)	litër	1000	800	100	100	0	0	0	0

VO: Sasia do të ndryshojë në varësi të ngarkesës së punës.

AFATI LEVRIMIT: Deri në ezaurimin e fondit limit.

- Sasitë e pa konsumuara të karburantit ruajnë vlefshmërinë e tyre dhe pas afatit të përcaktuar, ku operatori ekonomik duhet të vazhdojë furnizimin me karburant nëpërmjet kartës elektronike, deri në konsumimin e plotë të gjithë sasisë së karburantit të blerë (dhe pas mbarimit të vitit kalendarik 2026).

Mënyra e lëvrimit:

-Bazuar ne VKM Nr. 561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", furnizimi me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Për këtë, operatori ofertues do të paraqesë dokumentacion se disponon pajisjet për ofrimin e këtij shërbimi.

-Operatori ekonomik duhet të garantojë furnizimin 24 orë pa ndërprerje.

-Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën që, kur e gjykon të nevojshme, të kerkojë kontrollin e cilësisë së karburantit. Shpenzimet për kontrollin të përballohen nga opertatori ekonomik.

Kriteret teknike, grafiku i lëvrimit janë hartuar nga specialisti i fushës me shkresën me nr. 449/15 prot., datë 30. 04. 2026

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, grafikut te levrimit si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte te Tenderit, për procedurën me objekt prokurimi te sipercituar.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-se.

NJËSIA E PROKURIMIT